



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 25

Datë 6 mars 2014

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8495 datë 18.2.2014	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 595
Dekret nr. 8496 datë 18.2.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 595
Vendim i KM nr. 52, datë 5.2.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”..... 595
Vendim i KM nr. 89, datë 19.2.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1466, datë 5.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Libofshë të qarkut të Fierit”, dhe nr. 558, datë 7.5.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Libofshë e qarkut të Fierit”..... 599
Vendim i KM nr. 90, datë 19.2.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 1010, datë 13.11.2013 të Këshillit të Ministrave “Per emërimin e bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar”..... 603
Vendim i KM nr. 91, datë 19.2.2014	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Kuvendin e Shqipërisë..... 603

Vendim i KM nr. 92, datë 19.2.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret, procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar.....	603
Vendim i KM nr. 93, datë 19.2.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar.....	604
Vendim i KQZ nr. 10, datë 19.2.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	609
Vendim i KQZ nr. 12, datë 19.2.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	610
Vendim i ERE nr. 12, datë 14.2.2014	Mbi shqyrtimin dhe miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” paraqitur nga TAP AG në bazë të “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP.....	611
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Haxhi Tata.....	613

DEKRET
Nr. 8495, datë 18.2.2014

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Altin Bashkim Merdani
2. Ivi Xhevdet Çumani
3. Shpëtim Fatmir Alhasa
4. Miranda Sheme Çela (Deda)
5. Enkeleda Maksim Isufi (Shapka)
6. Samanda Nadi Trashani
7. Haxhire Luan Eminaj
8. Fadil Gani Beqiri
9. Saimir Vehbi Suçi
10. Eliana Jahja Dollapaj (Koprencka)
11. Ismet Osmën Kajolli
12. Hamide Kujtim Kajolli (Gega)
13. Ermelinda Bashkim Sovljanski (Avdulaj)
14. Mergita Leonidha Platen (Rebi)
15. Fredi Viktor Doda
16. Jani Pëllump Kovllari
17. Etleva Haxhi Sula-Gremi (Sulaj)
18. Saide Ibrahim Banushaj (Culaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET
Nr. 8495, datë 18.2.2014

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Arsimit e Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Shkelzen Sejdi Berisha
2. Luljeta Aziz Krasniqi
3. Blerand Avni Rama
4. David Nue Domgjonas (Domgjoni)
5. Heroid Muhamet Gjoshi
6. Agim Sali Zeka
7. Ardit Ragip Humolli (Humoli)
8. Endrit Fatmir Grainca

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

VENDIM
Nr. 52, datë 5.2.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 117,
DATË 13.2.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KRITERET QË PËRCAKTOJNË KUR DISA
TIPA TË METALIT SKRAP PUSHOJNË SË QENI
MBETJE”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 5 të kreut V, ndryshohen si më poshtë vijon:

“1. Një prodhues do të implementojë një sistem të menaxhimit të cilësisë, të përshtatshëm për të demonstruar përputhshmërinë me kriteret që janë përcaktuar në krerët 3 dhe 4 të këtij vendimi. Dokumentimi i cilësisë të bëhet duke iu referuar kodit ndërkombëtar të klasifikimit të skrapeve të aluminit ISRI dhe të hekurit HMS1, HMS2.”.

...

¹ Rregullorja e BE-së nr. 333/2011, datë 31.3.2011, sipas direktivës 2008/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

“5. Inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin verifikon që sistemi i menaxhimit dhe i cilësisë përputhen me kërkesat e kësaj pike. Verifikimet duhet të kryhen vazhdimisht nga Inspektorati Qendror Teknik, në përputhje me nenet 9 dhe 31 të ligjit nr. 10480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”. ”.

2. Aneket shoqëruese të vendimit nr. 117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave, të zëvendësohen

me anekset I dhe II, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI I KRITERET PËR SKRAPIN E HEKURIT DHE TË ÇELIKUT

Kriteret	Kërkesat vetëmonitoruese
1. Cilësia e skrapit që rezulton nga operacioni i rikuperimit	
1.1 Skrapi do të kategorizohet sipas një specifikimi të klientit, një specifikimi të industrisë apo një standardi për përdorimin e drejtpërdrejtë në prodhimin e substancave apo objekteve metalike nga punimet apo fonderitë e çelikut.	Stafi i kualifikuar do të kategorizojë çdo dërgesë.
1.2 Shuma totale e materialeve të huaja (sterile) do të jetë $\leq 2\%$ në peshë. Materialet e huaja janë:	Frekuencat e duhura të monitorimit me kampionë do të vendosen duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:
1. metalet joferrike (përfshirë elementet e aliazheve në substratin e metalit ferrik) dhe materialet jometalike, të tilla si: dheu, pluhuri, izolimet dhe xhami;	1. modelin e pritur të variabilitetit (për shembull, siç tregohet nga rezultatet historike);
2. materialet e djegshme jometalike, të tilla: si goma, plastika, pëlhura, druri dhe substanca të tjera kimike ose organike;	2. risku i brendshëm i variabilitetit në cilësinë e mbetjeve të përdorura si input për operacionet e rikuperimit dhe ndonjë përpunim të mëvonshëm;
3. copa më të mëdha (të madhësisë së tullës), të cilat nuk janë përcjellëse të elektricitetit, të tilla: si gommat, tubat e mbushura me çimento, druri ose betoni;	3. saktësimi i brendshëm i metodës së monitorimit; dhe
4. mbetjet që dalin nga shkrirja e çelikut, nxehja, kondicionimi i sipërfaqes (duke përfshirë lidhjen nyjë), bluarjen, sharrimin, saldimin dhe operacionet e prerjes me projektorë, të tilla: si skorje, ashkla freze, pluhur, pluhur i bluar, llumi.	4. afrimi i rezultateve të limitimit i përmbajtjes së materialeve të huaja deri te një minimum prej 2% për peshë.
1.3 Skrapi nuk do të përmbajë oksid ferrik të tepërt në ndonjë formë, me përjashtim të shumave tipike që lindin nga magazinimi jashtë i skrapit të përgatitur në kushte atmosferike normale.	Procesi i përcaktimit të shpeshtësisë së monitorimit duhet të dokumentohet si pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe duhet të jetë në dispozicion për auditim.
1.4 Skrapi nuk do të ketë vaj, emulsione vaji, lubrifikantë ose graso të dukshme, përjashtuar shumat e neglizhuara që nuk çojnë në ndonjë rrjedhje.	Stafi i kualifikuar do të monitorojë radioaktivitetin e çdo dërgese.
1.5 Radioaktiviteti dhe përmbajtja e tij në skrapet metalike do të jetë në nivelet që parashikohen në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar.	Çdo dërgesë skrapit do të shoqërohet nga një certifikatë që hartohet në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare për procedurat e monitorimit dhe të reagimit për skrapin metalik radioaktiv.
1.6 Skrapi nuk duhet të shfaqë ndonjë prej vetive të mbetjeve që i klasifikojnë ato si të rrezikshme, të përcaktuara në shtojcën 3 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Skrapi do të jetë në përputhje me kufijtë e përqendrimit të parashikuar në anekset IV dhe V të këtij vendimi.	Certifikata mund të përfshihet në ndonjë dokumentacion tjetër që shoqëron dërgesën.
Cilësitë e elementeve individuale, të përfshira në aliazhet e hekurit dhe të çelikut, nuk janë relevante për këtë kërkesë.	
1.7 Skrapi nuk do të përmbahet në ndonjë kontejner nën presion, të mbyllur apo të hapur në mënyrë të pamjaftueshme që mund të shkaktojnë ndonjë shpërthim në furnaltën e punimeve metalike.	

2. Mbetjet e përdorura si input për operacionin e rikuperimit

2.1 Vetëm mbetjet që përmbajnë hekur ose çelik të rikuperueshëm mund të përdoren si input. 2.2 Mbetjet e rrezikshme nuk do të përdoren si input përveç rastit kur provohet se janë aplikuar proceset dhe teknikat e specifikuara në seksionin 3 të këtij aneksi për të larguar të gjitha cilësitë e rrezikshme. 2.3 Mbetjet e mëposhtme, që nuk do të përdoren si input, janë: a) mbetje limimi që përmbajnë lëngje të tilla, si vaji ose emulsione vaji; dhe b) fuçi dhe kontejner përveç pajisjeve nga automjetet në fund të jetës, të cilët përmbajnë ose kanë përmbajtur vaj ose bojëra.	Kontrolli i pranimit të të gjitha mbetjeve të marra dhe të dokumentacionit shoqërues do të kryhen nga stafi i kualifikuar, i cili është trajnuar se si të njohë mbetjet që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë seksion.
---	---

3. Proceset dhe teknikat e trajtimit

3.1 Skrapi i hekurit ose i çelikut duhet të jetë i ndarë në burim ose kur mbledhet dhe duhet të mbahet i ndarë ose mbetja input duhet të trajtohet duke e ndarë skrapin e hekurit dhe të çelikut nga komponentët jometalike dhe joferrikë.

3.2 Të gjitha trajtimet mekanike (si: prerjet, ashklat, grisjet ose granulimet, ndarjet, ndarjet në lloje, pastrimi, heqja e ndotjes, boshatisja), që nevojitet për të përgatitur metalin skrap për input të drejtpërdrejtë në përdorimin përfundimtar në punimet dhe fonderitë e çelikut duhet të jenë të plotësuar.

3.3 Për mbetjet që përmbajnë komponentë të rrezikshëm, do të aplikohen kërkesat e mëposhtme specifike:

a) materialet input që e kanë origjinën nga pajisjet mbetje elektrike ose elektronike, ose nga automjetet në fund të jetës duhet t'u jenë nënshtruar të gjitha trajtimeve që kërkon vendimi i Këshillit të Ministrave "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 10.10.2012 "Për menaxhimin e mbetjeve nga automjetet në fund të jetës";

b) klorofluorokarbonet në pajisjet e hedhura duhet të jenë kapur në një proces të miratuar nga autoritetet kompetente;

c) kabllot duhet të jenë të zhveshura dhe të copëtuara. Në qoftë se një kabllo përmban veshje organike (plastike), veshjet organike duhet të jenë hequr në përputhje me teknikat më të mira në dispozicion;

d) fuçitë dhe kontejnerët duhet të jenë boshatisur dhe pastruar; dhe

e) substancat e rrezikshme në mbetje, që nuk përmenden në pikën "a" duhet të jenë larguar në mënyrë eficiente në një proces që miratohet nga autoriteti kompetent.

ANEKSI II**KRITERET PËR SKRAPIN E ALUMINIT**

Kriteret	Kërkesat vetëmonitoruese
1. Cilësia e skrapit	
1.1 Skrapi do të shkallëzohet në përputhje me një specifikim klienti, një specifikim industrie ose një standard për përdorimin e drejtpërdrejtë në prodhimin e substancës metalike ose të objektit duke e rafinuar ose rishkrirë. 1.2 Sasia totale e materialeve të huaja do të jetë $\leq 5\%$ për peshë ose rendimenti metalik do të jetë $\geq 90\%$. Materialet e huaja janë: 1. materiale jometalike, të tilla si: dheu, pluhuri, materiale izolimi dhe qelqi; 2. materiale jometalike të djegshme, të tilla si: goma, plastika, pëlhura, druri dhe substanca të tjera kimike ose organike; 3. pjesë më të mëdha (madhësia e tullës), të cilat nuk janë përçuese të elektricitetit, të tilla si: goma, tubat e mbushur me çimento, druri ose betoni; ose	Stafi i kualifikuar do të shkallëzojë çdo dërgesë. Frekuencat e duhura të monitorimit me kampionë do të vendosen duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm: 1. modelin e prituri të variabilitetit (për shembull, siç tregohet nga rezultatet historike); 2. risku i brendshëm i variabilitetit në cilësinë e mbetjeve të përdorura si input për operacionet e rikuperimit dhe

4. mbetjet që lindin nga shkrirja e aluminit dhe aliazheve të aluminit, nxehjes, kushtëzimit të sipërfaqes (duke përfshirë lidhjen nyjë), bluarjen, sharrimin, saldimit dhe operacionet e prerjes me projektorë, të tilla si: skorje, ashkla freze, pluhur, pluhur i bluar, llumi. 1.3 Skrapi nuk do të përmbajë polivinil kloridi (PVC) në formë veshjeje, bojërash, plastike. 1.4 Skrapi nuk do të ketë vaj, emulsione vaji, lubrifikantë ose graso të dukshme, përjashtuar sasi të neglizhueshme që nuk çojnë në ndonjë rrjedhje. 1.5 Radioaktiviteti. Nuk ka nevojë për veprime reaguese në përputhje me rregullat kombëtare apo ndërkombëtare për procedurat e monitorimit dhe të reagimit për metalin skrap radioaktiv. Kjo kërkesë nuk paragjykon standardet bazë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të publikut, të cilat parashikohen në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, dhe legjislacionin përkatës në Shqipëri. 1.6 Skrapi nuk duhet të shfaqë ndonjë prej vetive të mbetjeve që i klasifikojnë ato si të rrezikshme, të përcaktuara në shtojcën 3 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Skrapi do të jetë në përputhje me kufijtë e përqendrimit të parashikuar në anekset IV dhe V të këtij vendimi. Cilësitë e elementeve individuale, të përfshira në aliazhet e aluminit, nuk janë relevante për këtë kërkesë. 1.7 Skrapi nuk do të përmbahet në ndonjë kontejner nën presion, të mbyllur apo të hapur, në mënyrë të pamjaftueshme që mund të shkaktonte ndonjë shpërthim në furmaltën e punimeve metalike.	ndonjë përpunim të mëvonshëm; 3. saktësimi i brendshëm i metodës së monitorimit; dhe 4. afrimi i rezultateve të limitimit i përmbajtjes së materialeve të huaja deri të një minimum prej 2% për peshë. Procesi i përcaktimit të shpeshësisë së monitorimit duhet të dokumentohet si pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe duhet të jetë në dispozicion për auditim. Stafi i kualifikuar do të monitorojë radioaktivitetin e çdo dërgese. Çdo dërgesë skrap do të shoqërohet nga një certifikatë që hartohet në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare për procedurat e monitorimit dhe të reagimit për metalin skrap radioaktiv. Certifikata mund të përfshihet në ndonjë dokumentacion tjetër që shoqëron dërgesën.
2. Mbetjet e përdorura si input për operacionin e rikuperimit 2.1 Vetëm mbetjet që përmbajnë alumin ose aliazhe alumini të rikuperueshëm mund të përdoren si input. 2.2 Mbetjet e rrezikshme nuk do të përdoren si input, përveç rastit kur provohet se janë aplikuar proceset dhe teknikat e specifikuara në seksionin 3 të këtij aneksi për të larguar të gjitha cilësitë e rrezikshme. 2.3 Mbetjet e mëposhtme nuk do të përdoren si input: a) mbetje limimi që përmbajnë lëngje, të tilla si vaji ose emulsione vaji; dhe b) fuçi dhe kontejner përveç pajisjeve nga automjetet në fund të jetës, të cilat përmbajnë ose kanë përmbajtur vaj ose bojëra.	Kontrolli i pranimi të të gjitha mbetjeve të marra dhe të dokumentacionit shoqërues do të kryhen nga stafi i kualifikuar, i cili është trajnuar se si të njohë mbetjet që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë seksion.
3. Proceset dhe teknikat e trajtimit 3.1 Skrapi i aluminit duhet të jetë i ndarë në burim ose kur mblidhet dhe duhet të mbahet i ndarë ose mbetja input duhet të trajtohet duke e ndarë skrapin e aluminit nga komponentët metalikë joaluminë. 3.2 Të gjitha trajtimet mekanike (si: prerjet, ashklat, grisjet ose granulimet, ndarjet, ndarjet në lloje, pastrimi, heqja e ndotjes, boshatisja), që nevojitet për të përgatitur metalin skrap për input të drejtpërdrejtë në përdorimin përfundimtar duhet të jenë të plotësuar. 3.3 Për mbetjet që përmbajnë komponentë të rrezikshëm, do të aplikohen kërkesat e mëposhtme specifike: a) materialet lëndë e parë që e kanë origjinën nga pajisjet mbetje elektrike ose elektronike ose nga automjetet në fund të jetës duhet t'u jenë nënshtruar të gjitha trajtimeve që kërkon vendimi i Këshillit të Ministrave “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve nga automjetet në fund të jetës”; b) klorofluorokarbonet në pajisjet e hedhura duhet të jenë kapur në një proces të miratuar nga autoritetet kompetente; c) kabllo duhet të jenë të zhveshura dhe të copëtuara. Në qoftë se një kabllo	

përmban veshje organike (plastike), veshjet organike duhet të jenë hequr në përputhje me teknikat më të mira në dispozicion;
d) fuqitë dhe kontejnerët duhet të jenë boshatisur dhe pastruar; dhe
e) substancat e rrezikshme në mbetje, që nuk përmenden në pikën “a”, duhet të jenë larguar në mënyrë eficiente në një proces që miratohet nga autoriteti kompetent.

VENDIM**Nr. 89, datë 19.2.2014****VENDOSI:**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 1466, DATË 5.11.2008 “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHITETËRORE NË KOMUNËN
LIBOFSHË TË QARKUT TË FIERIT”, DHE NR.
558, DATË 7.5.2008 “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE
DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN
NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES
VENDORE, KOMUNA LIBOFSHË E QARKUT
TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

Në vendimet e mëposhtme të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Lista, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1466, datë 5.11.2008 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me listën e inventarit sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista ka 6 (gjashtë) fletë me numër rendor nga 1 deri 54.

2. Listës, që i bashkëlidhet vendimit nr. 558, datë 7.5.2008 të Këshillit të Ministrave, i shtohet lista e dhënë në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista ka 2 (dy) fletë me numër inventari 1-3, 34, 36-37, 40, 43-54.

3. Lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 558, datë 7.5.2008 të Këshillit të Ministrave, i shtohet lidhja sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta, të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Komuna: Libofshë									
Fusha e përdorimit të Pronës: Pyje kullota									
Nr. Rend.	Emertesa e Ekosistit Pyjorë dhe Kulloror (EPK) Shtetja Gjeografike e EPK	Emertesa e Ngastres Vend ndodhja (sipas emertës popullore)	Numeri i Ngastres	Destinacioni	Sipërfaqja në ha.	Funkcioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni përgjegjës administrativ	Institucioni Enti Përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënimet të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Eko. Pyj. Vajkan	Mali Libofshës	1/a	Prodhuar	20	Dr. Zgarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
2	Eko. Pyj. Vajkan	Mali Libofshës	1/b	Prodhuar	6	L. Punimi	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
3	Eko. Pyj. Vajkan	Mali Libofshës	2/b	Prodhuar	4	L. Punimi	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
4	Bregu Seman	Bregu i lumit	10	Mbrojtjes	14	Z. Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
5	Bregu Seman	Gryka e semanit	11	Mbrojtjes	38	Z. Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombëtar
6	Bregu Seman	Gryka e semanit	12/a	Mbrojtjes	11	Z. Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
7	Bregu Seman	Gryka e semanit	12/b	Mbrojtjes	11	Z. Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta, të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

8	Bregu Sëman	Gryka e sëmanit	12/a	Mbrojtes	5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
9	Bregu Sëman	Gryka e sëmanit	13	Mbrojtes	12	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
10	Bregu Sëman	Gryka e sëmanit	14	Mbrojtes	27.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
11	Bregu Sëman	Sheshi i Shellures	15/a	Mbrojtes	39.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
12	Bregu Sëman	Kthesa e l. sëman	15/b	Mbrojtes	1.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
13	Bregu Sëman	Bregu i Detit	16	Mbrojtes	9	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
14	Bregu Sëman	Pylli i Godulles	17/a	Mbrojtes	4.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
15	Bregu Sëman	Pylli i Godulles	17/b	Mbrojtes	3	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
16	Bregu Sëman	Pylli i Godulles	17/c	Mbrojtes	7.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
17	Bregu Sëman	Marina e Godulles	18/a	Mbrojtes	6	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
18	Bregu Sëman	Marina e Godulles	18/b	Mbrojtes	22.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP	

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta, të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

								Fier	
19	Bregu Sëman	Marina e Godulles	19/a	Mbrojtes	8.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
20	Bregu Sëman	Beset e Godulles	19/b	Mbrojtes	10	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
21	Bregu Sëman	Bregu i Godulles	19/c	Mbrojtes	5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
22	Bregu Sëman	Beset e Godulles	20	Mbrojtes	20	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
23	Bregu Sëman	Bregu i Detit	21/a	Mbrojtes	2	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
24	Bregu Sëman	Pisha e hidrovores	21/b	Mbrojtes	7.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
25	Bregu Sëman	Marina e hidrovores	21/c	Mbrojtes	11.5	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
26	Bregu Sëman	Bregu i Godulles	21/d	Mbrojtes	2	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
27	Bregu Sëman	Lera e kopaces	43	Mbrojtes	200	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar
28	Bregu Sëman	Marina	44	Mbrojtes	752	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombetar

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta, të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

29	Bregu Sëman	Godullat Ushnait	45	Mbrojtjes	33	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
30	Bregu Sëman	Godulla e Zallit	46	Mbrojtjes	179	Z.Mbrojt.	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombëtar
31	Lumi I Sëmanit I	Bunkieri I Gjermanit	1/a	Prodhuës	5.2	Dr.Zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombëtar
32	Lumi I Sëmanit I	Shtreti I Lumit	1/b	Prodhuës	7	Dr.Zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Park Kombëtar
33	Lumi I Sëmanit I	Argjinatura	2	Prodhuës	18	L.Punimi	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
34	Lumi I Sëmanit I	Blloku I Ilukes	4/a	Prodhuës	9.83	Dr.Zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
35	Lumi I Sëmanit I	Brezi I Argjinatures	4/b	Prodhuës	21.2	Dr.Zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
36	Lumi I Sëmanit I	Pylli I Gogës	5	Prodhuës	5	Dr.Zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
37	Lumi I Sëmanit I	Pylli I Gogës	6/a	Prodhuës	10.2	Dr.Zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
38	Lumi I Sëmanit I	Kurora e Lumit	6/b	Prodhuës	3.8	Dr.Zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta, të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

39	Lumi I Sëmanit I	Shtreti I Lumit	6/c	Prodhuës	2	Bosh	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
40	Lumi I Sëmanit I	Kurora e Lumit	6/d	Prodhuës	2	Bosh	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
41	Lumi I Sëmanit I	Ana e Lumit	6/e	Prodhuës	3.3	Dr.Zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
42	Lumi I Sëmanit I	Brezi I argjinatures	7/a	Prodhuës	2.9	Bosh	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
43	Lumi Sëman I	Brezi I argjinatures	7/b	Prodhuës	7	Dr.zjarri	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
44	Lumi I Sëmanit I	Kurora	8/a	Prodhuës	3.7	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
45	Lumi I Sëmanit I	Kurora	8/b	Prodhuës	7.2	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
46	Lumi I Sëmanit I	Kurora	8/c	Prodhuës	4.5	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
47	Lumi I Sëmanit I	Kurora	8/d	Prodhuës	0.8	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
48	Lumi I Sëmanit I	Kurora	9/a	Prodhuës	11	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE (Për inventarizimin e pronave të veçanta, të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

49	Lumi I Semanit I	Kurora	9/b	Prodhues	5.7	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
50	Lumi I Semanit I	Kurora	9/c	Prodhues	2	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
51	Lumi I Semanit I	Kurora	9/d	Prodhues	6.3	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
52	Lumi I Semanit I	Kurora	9/e	Prodhues	2.6	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
53	Lumi I Semanit I	Kurora	10	Prodhues	11	Bosh	M.M.P.A.U	DSHP Fier	
54	Lumi I Semanit I	Kurora	11	Prodhues	0.3	Dr.Zjarr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË TIPIT PYJE DHE KULLOTA (SHTOJCA 2)

Komuna: Libofshë

Fusha e përdorimit të Pronës: Pyje kullota

Nr. Rend.	Nr. promes sipas VKM	Emertesa e Ekonomisë Pyjore dhe Kullosore (EPK) Shtetja Gjeografike e EPK	Emertesa e Ngastres Vend ndodhja (sipas emertese popullore)	Numri i Ngastres	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni/Entiteti përgjegjës administrativ	Institucioni/Entiteti përgjegjës juridik i përdorimit	Shënime të veçanta (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
1	1	Eko. Pyj. Vajkan	Mali Libofshes	1/a	Prodhues	20	Dr.Zjarr	M.M.P.A.U	Komuna Libofshë	
2	2	Eko.Pyj.Vajkan	Mali Libofshes	1/b	Prodhues	6	L.Punimi	M.M.P.A.U		
3	3	Eko.Pyj.Vajkan	Mali Libofshes	2/b	Prodhues	4	L.Punimi	M.M.P.A.U		
4	34	Lumi I Semanit I	Biloku I Ilukes	4/a	Prodhues	9.83	Dr.Zjarr	M.M.P.A.U		
5	36	Lumi I Semanit I	Pylli I Goges	5	Prodhues	5	Dr.Zjarr	M.M.P.A.U		
6	37	Lumi I Semanit I	Pylli I Goges	6/a	Prodhues	10.2	Dr.Zjarr	M.M.P.A.U		
7	40	Lumi I Semanit I	Kurora e Lumit	6/d	Prodhues	2	Bosh	M.M.P.A.U		
8	43	Lumi Seman I	Brezi I argjinatures	7/b	Prodhues	7	Dr.zjarr	M.M.P.A.U		
9	44	Lumi I Semanit I	Kurora	8/a	Prodhues	3.7	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
10	45	Lumi I Semanit I	Kurora	8/b	Prodhues	7.2	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP Fier	Monument Natyre
11	46	Lumi I Semanit I	Kurora	8/c	Prodhues	4.5	M.natyr	M.M.P.A.U	DSHP	Monument Natyre

Komuna: Libofshë

Qarku: Fier

Lidhja nr. 1 (SHTOJCA 3)

Numrat e pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3, 34, 36-37, 40, 43-54	Pyje prodhues dhe monument natyre	Pronësi

VENDIM
Nr. 90, datë 19.2.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1010,
DATË 13.11.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E BORDIT TË
MENAXHIMIT PËR AUTORITETIN RRUGOR
SHQIPTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “a” të pikës 1 të vendimit nr. 1010, datë 13.11.2013 të Këshillit të Ministrave, fjalët “Z. Erjon Luçi, Ministria e Financave”, zëvendësohen me “Z. Gentian Opre, Ministria e Financave”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 91, datë 19.2.2014

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË
BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Kuvendin e Shqipërisë, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, llogaria ekonomike 606, të shtohet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh;

b) Në programin buxhetor 01120 “Veprimtaria

ligjvënëse”, llogaria ekonomike 602, të zbritet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen administrata e Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 92, datë 19.2.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 42,
DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
KRITERET, PROCEDURAT E DHËNIES SË
LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT,
KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË
SUBJEKTEVE JURIDIKE QË USHTROJNË
VEPRIMTARI NDËRTIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për kriteret, procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, të klasifikimit dhe të disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, që i bashkëlidhet vendimit nr. 42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 2 të kreut I “Përkufizime, ndryshohet si më poshtë vijon:

“**“Komision”**, struktura e posaçme administrative që krijohet sipas shkronjës “a” të pikës 1 të kreut II të kësaj rregulloreje e që asistohet nga stafi përgjegjës për veprimtari të licencimit në ministri, që ka autoritetin e vetëm për dhënien, ndryshimin a revokimin e licencave profesionale të shoqërive apo vendosjen e penaliteteve për subjekte që kryejnë veprimtari në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi brenda sferës së përgjegjësisë, që i janë dhënë sipas kësaj rregulloreje në fushën e zbatimit në ndërtim.”.

2. Shkronja “a” e pikës 1 të kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) Komisioni i Posaçëm i dhënies së licencave profesionale përbëhet nga pesë anëtarë:

- një përfaqësues nga Kryeministria, i cili do të jetë kryetar i Komisionit;

- një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;

- dy përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës;

- një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Detyrën e sekretariatit teknik të Komisionit e kryen drejtoria përgjegjëse për licencimin në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.”.

3. Kudo në rregullore, emërtimi “... Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ...”, zëvendësohet me “ ... Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës...”, ndërsa emërtimi “... sekretari teknike ...”, zëvendësohet me “... sekretariati teknik ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 93, datë 19.2.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.
1135, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të ministrit të Punëve të

Brendshme dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit përcaktohen si më poshtë vijon:

a) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për krimin e organizuar dhe krimet e rënda dhe Policinë Shkencore, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për sigurinë publike dhe rendin publik, sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për kufirin dhe migracionin, sipas lidhjes nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në struktura të tjera policore dhe administrative e mbështetëse sipas lidhjes nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Pika 5/1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5/1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që pranohet në shkollën bazë të policisë, gjatë kohës së qëndrimit në shkollë përfiton trajtim me pagë, në masën 8000 (tetë mijë) lekë kur ka përfunduar arsimin e mesëm dhe 9000 (nëntë mijë) lekë kur ka përfunduar arsimin e lartë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi për politikën e reja të pagave për Policinë e Shtetit, të parashikuara në buxhetin e vitit 2014.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 janar 2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja Nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për Krimin e organizuar dhe Krimet e Rënda dhe Policinë Shkencore

Shtesa per natyrë të veçantë pune e shërbimi													
Niveli	Grada	Në funksione të Drejtorisë së Forcës së Posaçme. Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda.	Në funksione të Sektorit të Hetimit në Mbulim në Drejtorinë e Forcës së Posaçme	Në funksione të Sektorit të Forcës së Posaçme dhe Kërkimin në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë	Në funksione të Sektorit të Forcës së Posaçme dhe Kërkimin në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë	Në funksione të Sektorit të Përpunimit të të Dënave dhe Ndihmës në Drejtorinë e Mbrojtjes së Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.	Në funksione të Sektorit të Përpunimit të të Dënave dhe Drejtorinë e Mbrojtjes së Policisë së Dëshmitarëve	Në funksione të Policisë Shkencore. Analizës së Riskut dhe Kriminal, Analizës së Riskut dhe Kartotekës, të Drejtorisë së Policisë Shkencore.	Në funksione të Policisë Shkencore (nd.spec, laborant), Teknologjia dhe Përgjimi.	Në funksione të Aktëve terroriste dhe Krimet e Rënda.	Në funksione të Sektorit të Financës, Arkivit dhe Protokollit në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve	Në funksione të luftës kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, Krimit Ekonomik e Financiar, Aktëve terroriste dhe Krimet e Rënda.	Në funksione të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse për Departamentin në për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda
Niveli i zbatues	Neninspektor	44500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
	Inspektor	49000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
	Kryeinspektor	54500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
Niveli i parë drejtues	Nenkomisar	65500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
	Komisar	72000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
	Kryekomisar	87000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000	6000	3000
Niveli i mesëm drejtues	Drejtues	99000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000	6000	3000
	Drejtues i l-re	103000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		

Lidhja Nr.2

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Shtesa per natyrë të veçantë pune e shërbimi											
Niveli	Grada									Në funksione të sektor/seksione të shërbimeve të të tretëve, Sektor/Seksio ne të sallës komandimit, Ndhimës- specialist per informacionin përgjegjës turni ; Specialist informacioni si dhe për marrjen e kallzymeve , Trupë shërbimi për trenat, ND- specialist ai specialist për zbatimin e vendimeve dhe kontrollin e armëve.	
Niveli i zbatues											
Niveli i drejtues											
Niveli i mesëm											
Niveli i drejtues											

Lidhja Nr.3

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Niveli	Grada	Shtesa per natyrë të veçantë pune e shërbimi					
		Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit
Niveli i parë drejtues	Neninspektor	44500	20000	7000	Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit
	Inspektor	49000	20000	7000	Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit
	Kryeinspektor	54500	20000	7000	Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit
Niveli i dytë drejtues	Nenkomisar	65500	20000	7000	Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit
	Komisar	72000	20000	7000	Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit
	Kryekomisar	87000	20000	7000	Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit
Niveli i tretë drejtues	Drejtuës	99000	20000	7000	Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit
	Drejtuës i Lartë	103000	20000	7000	Në funksione të Shërbimit të Përgjithshëm dhe të Ndërshtetit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit	Në funksione të Shërbimit të Kufirit dhe Migracionit

Lidhja Nr.4

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Shtesa per natyrë të veçantë pune e shërbimi									
Niveli	Grada		Në funksione të shërbimit të mbështetës në QPP, në drejtorinë e QPMDH, Sektorit/seksioni I marrëdhënieve me publikun, Seksi i Administrimit të dokumentet dhe përfaqësimit ligjor.	Në funksione të IPQP, Drejtoria e Standarteve Profesionale, Drejtor i QPMDH/Seksi i statistikave, në funksione të Help desk, dhe shërbimeve të IT.	Në funksione të Drejtorisë së Studimeve strategjike, Drejtor i QPP, Sektor i Shkollimit bazë policor, Seksi i trajnimit të drejtues, Seksi i për trajnimin e shkolimit e nivelit të mesëm e të lartë drejtues në QPP.	Në funksione të Drejtorisë së Bashkëpunimit dhe koordinimit Ndërkombëtar, Asistent sekretari i Zv drejtues të Përgjithshëm Shëf sektori asistent i drejtorit të PQ Tiranë.	Në funksione të Drejtorit të asistent /Sekret i Drejtorit të Përgjithshëm.	Në funksione të Drejtorit i Përgjithshëm, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm, drejtor i Policisë së Qarkut Tiranë.	Në funksione të Drejtor Qarku Zv drejtor Qarku dhe Shëf komisarati.
	Nëinspektori		44500	5500	5000	6500			
Niveli i zbatues	Inspektori		49000	5500	5000	6500			
	Kryeinspektori		54500	5500	5000	6500			
Niveli i parë drejtues	Nënkomisar		65500	5500	5000	6500			
	Komisar		72000	5500	5000	6500			8000
	Kryekomisar		87000	5500	5000	6500			8000
Niveli i mesëm drejtues	Drejtes		99000	5500	5000	6500	7000	17000	8000
	Drejtes i lartë		103000	5500	5000	6500	7000	17000	8000
Niveli i lartë drejtues	Zëvendës drejtor i Përgjithshëm		115000					17000	
	Drejtor i Përgjithshëm		125000					22000	

VENDIM
Nr. 10, datë 19.2.2014

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT
TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA
SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN
DURRËS, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.2.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetare
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Durrësit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Ermira Koçi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2 dhe neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 207 prot., datë 17.2.2014, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të znj. Ermira Koçi, deputete e zonës zgjedhore, qarku Durrës.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 33, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Durrës, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore, qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 1 mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim

për qarkun e Durrësit, është kandidati me numër rendor 1 (një) z. Lefter Koka.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Lefter Koka, deputet i zonës zgjedhore, qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 2, datë 20.1.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Silvana Maksuti.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Silvana Maksuti, deputete e zonës zgjedhore qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 6, datë 28.1.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Merita Kuçi.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Merita Kuçi, deputete e zonës zgjedhore, qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 7, datë 3.2.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Klodjana Pashkaj.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Klodjana Pashkaj, deputete e zonës zgjedhore, qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 9, datë 10.2.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Ermira Koçi.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun e Durrësit nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidat nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 4 milionë lekë ndaj Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e LSI-së, në zonën zgjedhore qarku Durrës, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03, rezulton se gjinia femërore, si gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumëmemërore, qarku Durrës, pas dorëheqjes së zj. Ermira Koçi, ka shteruar. Në mbështetje të nenit 164 pika 2 (fjalja e fundit), duke qenë se lista e gjinisë femërore ka shteruar, KQZ-ja nuk mund të zbatojë sanksionin plotësues.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, të zonës zgjedhore qarku Durrës.

Sipas listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun Durrës, kandidati vijues është kandidati, i cili renditet me numër rendor 2 (dy) z. Edmond Panariti. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumëmemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e znj. Ermira Koçi dhe shterimit të kandidateve të gjinisë femërore është z. Edmond Panariti.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 164 pika 2 dhe nenin 175, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, z. Edmond Qamil Panariti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kryetare: Lefterije Luzi (Lleshi)

Anëtarë: Hysen Osmanaj, Klement Zguri, Vera Shtjefni

VENDIM

Nr. 12, datë 19.2.2014

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN DURRËS, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 24.2.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetare
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Durrësit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit, të z. Edmond Panariti.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2 dhe neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 232 prot., datë 21.2.2014, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Edmond Panariti, deputet i zonës zgjedhore qarku Durrës.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 33, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Durrës, në zgjedhjet për Kuvendin, të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 1 mandat dhe kandidati fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun e Durrësit, është kandidati me numër rendor 1 (një) z. Lefter Koka.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Lefter Koka, deputet i zonës zgjedhore, qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 2, datë 20.1.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Silvana Maksuti.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të znj. Silvana Maksuti, deputete e zonës zgjedhore, qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 6, datë 28.1.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Merita Kuçi.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për

shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Merita Kuçi, deputete e zonës zgjedhore, qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 7, datë 3.2.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Klodjana Pashkaj.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të znj. Klodjana Pashkaj, deputete e zonës zgjedhore, qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 9, datë 10.2.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Ermira Koçi.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Edmond Panariti, deputet i zonës zgjedhore, qarku Durrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 10, datë 19.2.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Edmond Panariti.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun e Durrësit nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidat nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 4 milionë lekë ndaj Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e LSI-së, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03, rezulton se gjinia femërore, si gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumemërore, qarku Durrës pas dorëheqjes së znj. Ermira Koçi, ka shteruar. Në mbështetje të nenit 164 pika 2 (fjalë e fundit), duke qenë se lista e gjinisë femërore ka shteruar, KQZ-ja nuk mund të zbatojë sanksionin plotësues.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t’i kalojë kandidatit vijues të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, të zonës zgjedhore, qarku Durrës.

Sipas listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste

për Integrim për qarkun Durrës kandidati vijues është kandidati, i cili renditet me numër rendor 3 (tre) z. Bujar Derveni. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se personit, të cilit do t’i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e z. Edmond Panariti, është z. Bujar Skënder Derveni.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2 dhe neni 175, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, z. Bujar Skënder Derveni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kryetare: Lefterije Luzi (Lleshi)

Anëtarë: Hysen Osmanaj, Klement Zguri, Vera Shjefni

VENDIM

Nr. 12, datë 14.2.2014

MBI SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E “PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË RREGULLATORE/ REGULATORY COMPLIANCE PROGRAMME” PARAQITUR NGA TAP AG NË BAZË TË “OPINIONIT TË PËRBASHKËT PËRFUNDIMTAR /FINAL JOINT OPINION” NË KUADËR TË PROCEDURËS SË PËRJASHTIMIT PËR GAZSJELLËSIN TAP

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.2.2014,

Në zbatim të:

- Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: Direktiva 73/09);

- Rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009;

- Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009;

- Ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;

- Vendimit nr. 27, datë 1.3.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP – AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”;

- Vendimit të Komisionit Evropian C (2013) 2949, të datës 16 maj 2013 “*Exemption of Trans Adriatic Pipeline from the requirements on third party access, tariff regulation and ownership unbundling laid down in Articles 9, 32, 41(6), 41(8) and 41(10) of Directive 2009/73/EC*”;

- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) të datës 14 maj 2013;

- Vendimit nr. 64, datë 13.6.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 1.3.2013 “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian (C(2013)2949” nëpërmjet miratimit të dokumentit “Opinion i Përbashkët Përfundimtar i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)”/ “Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG's Exemption Application Autorita per l'Energia Elettrica e il Gas (Italy), Enti Rregullator i Energjisë (Albania) and Regulatory Authority of Greece (Greece)” në vijim *Final Joint Opinion*;

- Vendimit nr. 127, datë 7.11.2013 “Mbi miratimin e metodologjisë së tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar /Final Joint Opinion” në kuadër të procedurës për përjashtimin e gazsjellësit TAP;

- Kërkesës së TAP AG të datës 8 janar, protokolluar prej ERE-s, me nr. prot. 56, datë 14.1.2014;

- Kërkesës së TAP AG datë 5 shkurt 2014 (prot. hyrës nr. 56/1, datë 8.2.2014), për miratimin e draftit final të “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, i dorëzuar më parë, më 15 nëntor 2013 (nr. protokollit hyrës 500/19). E njëjta kërkesë i është paraqitur njëkohësisht dhe në të njëjtën formë edhe Autoriteteve Rregullatore të Italisë (AEEG) dhe të Greqisë (RAE).

Duke konsideruar, që:

- Shoqëria TAP AG ka paraqitur në ERE, në përputhje me ligjin nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, kërkesën për përjashtim në

lidhje me projektin e një interkonjektori që kalon nga Greqia dhe nga Shqipëria, për të vijuar në Itali (në vijim “Gazsjellësi TAP”) dhe si të tillë për efekt të përjashtimit është e nevojshme përfshirja edhe e Autoriteteve Rregullatore (në vijim “Autoritetet”) për Greqinë, Enti Rregullator i Energjisë (në vijim “RAE”) dhe për Italinë, Autoriteti për Energjinë, Gazin dhe Ujërat (në vijim “AEEG”);

- Kjo kërkesë përfshinte, ndër të tjera, përjashtimin nga neni 9.1 i direktivës së gazit (2009/73/EC) (në vijim përjashtim nga kushti për ndarjen pronësore);

- ERE, me vendimin nr. 27, datë 1.3.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendosi “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP – AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”;

- Me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s miratoi amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 1.3.2013 “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian (C(2013)2949”, nëpërmjet miratimit të dokumentit “Opinion Përfundimtar i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim”;

- Paragrafi 4.5 i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion përjashton TAP AG nga detyrimi i ndarjes pronësore për një periudhë prej 25 vjetësh nga momenti i vënies në funksionim të infrastrukturës gazsjellëse;

- Gjithashtu, paragrafi 4.5.1 i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion e detyron TAP AG të vendosë në zbatim *unbundling* funksional përpara se të alokojë kapacitetet si rezultat i Fazës së Parë të Prenotimit (*First Booking Phase*) të parashikuar më 17 mars 2014, siç komunikuar nga TAP AG në shkresën e datës 8 janar 2014 (prot. hyrës nr. 56, datë 14.1.2014).

- Në mënyrë të veçantë, paragrafi i sipërcituar i Final Joint Opinion e detyron TAP AG:

1. Të zhvillojë një “Program të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, i cili duhet të paraqitet për miratim në të tre rregullatorët, me qëllim për të garantuar trajtimin e barabartë të pjesëmarrësve në *Booking Phase* dhe për të parandaluar rrjedhjen e informacionit me interes tregtar ndaj aksionerëve.

2. Të përcaktojë një person që do të jetë përgjegjës, Oficeri i Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Officer (RCO), jo më vonë se një muaj nga

data e miratimit të Programit të Përputhshmërisë nga Rregullatorët.

- Gjithashtu, paragrafi i sipërcituar parashikon se “Programi i Përputhshmërisë Rregullatore/ Regulatory Compliance Programme”, duhet të përcaktojë të paktën:

a) Masat e ndërmarra për të garantuar trajtimin e barabartë të pjesëmarrësve në Fazën e Prenotimit/ Booking Phase të parë;

b) Detyrimet që duhet të përmbushin nëpunësit e TAP AG, me qëllim për t’iu përmbajtur Programit të sipërcituar;

c) Personin dhe organin përgjegjës për të kontrolluar Programin e Përputhshmërisë dhe Prezantimit të një raporti vjetor mbi masat e miratuara nga Rregullatorët;

d) Parimet që lidhen me metodologjinë e tarifave dhe rregullave të menaxhimit të kapaciteteve të komercializuara nga TAP AG.

- Referuar specifikisht shkronjës “d” më sipër, programi në fjalë, nga njëra anë, rinovon parimet e metodologjisë së tarifave të përcaktuara në TAP Tariff Code (miratuar nga ERE me vendimin nr. 127, datë 7.11.2013) dhe, nga ana tjetër, përcakton që rregullat e menaxhimit të kapaciteteve do të jenë objekt i Kodit të Rrjetit, që në bazë të paragrafit 4.7, pika 1 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion, TAP AG do të paraqesë për miratim nga Rregullatorët jo më vonë se 1 vit para vendosjes në punë të infrastrukturës gazsjellëse;

- Së fundi, paragrafi 4.5, pika 2 i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion, parashikon që TAP AG të certifikohet në cilësinë e Operatorit të Pavarur të Transmetimit (ITO) para vendosjes në punë të infrastrukturës gazsjellëse, por jo më vonë se 1 janari 2018;

- Në datën 5 shkurt 2014, shoqëria TAP AG, në përputhje me paragrafin 4.5, pika 1 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion, ka paraqitur një propozim të Programit të Përputhshmërisë,

drejtuar enteve ERE, AEEG dhe RAE, me qëllim për të siguruar aprovimin e këtij Programi.

Duke vlerësuar që:

- Programi i Përputhshmërisë Rregullatore është konform përcaktimeve të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion të evidentuara më lart (shkronjat “a” – “d”) dhe se parashikon, ndër të tjera, që çdo ndryshim i mundshëm në përmbajtjen e tij është objekt i miratimit nga ana e rregullatorëve;

- I njëjti qëndrim është ndarë dhe mbajtur dhe nga AEEG dhe RAE;

- Është i nevojshëm miratimi i Programit të Përputhshmërisë së Propozuar sipas paragrafit 4.5 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për të garantuar trajtimin e barabartë të pjesëmarrësve në Fazën e Prenotimit/ Booking Phase të parë.

VENDOSI:

1. Të miratojë “Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, të propozuar nga TAP AG në datën 5 shkurt 2014, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Njoftimin e Autoriteteve Rregullatore të Energjisë të Italisë (AEEG) dhe të Greqisë (RAE) dhe TAP AG për marrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 12 (64 - 2014 - 44), datë 16.1.2014, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Haxhi Tata dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij shtetasit Adem Tata.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë

Adresa: bulevardi “Gjergj Fishta”, pas ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006